Projekt i financuar nga Bashkimi Evropian

PARTNERËT SHQIPËRI PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Project Ahead Società cooperativa

Comitato don Peppe Diana

**C.A.U.S.E. – Përdorimi i Pronave të Konfiskuara për Sipërmarrje Sociale** është iniciativa e parë e kësaj natyre e zbatuar në Shqipëri dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor, që synon të krijojë një model të ri-përdorimit të qendrueshëm të aseteve të konfiskuara nga krimi i organizuar, nga organizatat e shoqërisë civile. C.A.U.S.E. zbatohet nga Partnerët Shqipëri, në partneritet me Project Ahead dhe Comitato Don Peppe Diana, dhe në bashkëpunim me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Projekti financohet nga Bashkimi Evropian.

*Buxheti total:* 59,978.86 Euro

*Kontributi i BE:* 56,979.92 Euro (95%)

*Periudha e zbatimit:* 3 maj 2019 – 2 maj 2020

*Organizata zbatuese:* Instituti i Zhvillimit, Migracionit dhe Integrimit (IMZHI)

# Garazhi Social i Artizanatit

**Garazhi Social i Artizanatit** është një punishte e ngritur në një pronë të konfiskuar nga krimi i organizuar në Sarandë, ku gra dhe vajza – viktima apo në rrezik nga krimi i organizuar dhe dhuna në familje, prodhojnë punime artizanale duke përdorur gurët e detit (shumëngjyrësh, njëngjyrësh, të sheshtë, shkëmb, qelqi, etj.). Gurët ngjyrosen, shpohen, gdhenden dhe punohen duke krijuar produkte të ndryshme artizanale të gatshme për treg.

Modelet e punimeve ndërlidhen me trashëgiminë kulturore dhe folklorin duke i bërë këto produkte unike, të vlefshme dhe konkurruese në tregun artizanal, në mënyrë që të sigurohet gjenerimi i të ardhurave në nivel afatgjatë.

Duke i dhënë një fytyrë të re pronës së konfiskuar, sipërmarrja përçon një mesazh të fuqishëm mbi vlerën që ka ri-përdorimi i këtyre aseteve në mbështetje të përfshirjes sociale dhe zhvillimin e ekonomisë lokale.

## Gjatë vitit të parë të zbatimit

- **8 vajza dhe gra** viktima apo në rrezik nga krimi i organizuar dhe dhuna në familje të trajnuara dhe punësuara mbi prodhimin artizanal të gurit;
- Garazhi Social i Artizanatit Sarandë shërben si një **Hub Social** në mbështetje të integrimit ekonomik dhe social të grave dhe vajzave në jetën e qytetit;
- Mbi **1,000** produkte artizanale të prodhuara me gurë deti;
- **2 programe trajnimi** mbi trashëgiminë kulturore dhe të drejtat e njeriut;
- Organizimi i **2** ekspozitave lokale.





Social Crafting Garage Saranda

**Koordinatore Projekti:** Drita Avdyli
+355 69 84 83 173
avdylidrita@yahoo.com

Rruga Gjergj Arianiti nr. 205, Saranda